



# **AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

## **Dobësi e Shfrytëzuar Aktivisht në Wing FTP Server**

Data: 17/03/2026  
Version: 1.0

## Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive .....	1
Informacione Teknike .....	1
Rekomandime .....	2
Referenca .....	2

### Përmbledhje Ekzekutive

---

Është identifikuar një dobësi në **Wing FTP Server** që po shfrytëzohet aktivisht nga aktorë keqdashës. Kjo dobësi lejon sulmuesit të zbulojnë informacion sensitiv të brendshëm të serverit, i cili mund të përdoret për sulme të mëtejshme dhe komprometim më të thellë të sistemit.

### Informacione Teknike

---

#### Detaje të Dobësisë:

- **CVE ID:** CVE-2025-47813
- **Rrezikshmëria:** Mesatare
- **CVSS:** 4.3
- **Lloji i dobësisë:** Zbulim informacioni

Dobësia ndodhet në endpoint-in **/loginok.html** të Wing FTP Server dhe shkaktohet nga validimi i pasaktë i gjatësisë së cookie-së së sesionit **UID**.

Një sulmues i autentikuar mund ta shfrytëzojë këtë dobësi duke dërguar një kërkesë **POST** të manipuluar me një vlerë UID shumë të gjatë, që tejkalon madhësinë maksimale të path-it të mbështetur nga sistemi operativ. Kjo shkakton një përgjigje gabimi që zbulon path-in e plotë lokal të sistemit të skedarëve të aplikacionit.

Ky informacion mund të përdoret për:

- hartëzimin e direktorive të brendshme
- identifikimin e vendndodhjeve të skedarëve sensitivë
- mbështetjen e shfrytëzimeve të mëtejshme, përfshirë kombinimin me dobësi të tjera si **CVE-2025-47812**

#### Versionet e Prekura

- Wing FTP Server versionet para 7.4.4

#### Versionet e Korrigjuara

- Wing FTP Server version 7.4.4 dhe më të reja

## **Rekomandime**

---

Rekomandohet përditësimi i versioneve të prekura në versionet e korrigjuara ose në versionet më të fundit të publikuara nga Wing FTP.

## **Referenca**

---

<https://nvd.nist.gov/vuln/detail/CVE-2025-47813>